



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 235/2019

Datë: 6 nëntor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ramiz Azizi, Kryetar në Gjykatën Themelore Gjilan, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/01/2019-GJS-2019-002, të datës 9 tetor 2019, pas shqyrtimit të mbajtur më datë 6 nëntor 2019, në pajtim Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 226-të, të mbajtur më datë 6 nëntor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Ramiz Azizi, Kryetar në Gjykatën Themelore Gjilan **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5 paragraf 1, nën paragraf 1.3 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.11 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.146/2019, të datës 21 qershor 2019, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/01/2019-GJS-2019-002, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljen e pretenduar disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi, i cili dyshohet se gjatë dhënies së dëshmisë në cilësinë e dëshmitarit në çështjen kontestimore me C.nr.79/2017, ka bërë sjellje të pahijshme.

Për të shqyrtuar këtë çështje Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 6.11.2019 ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore, në të cilën morën pjesë Kryesuesi i panelit hetimor Mustaf Tahiri dhe Kryetari Ramiz Azizi. Kryesuesi i panelit hetimor në fillim të seancës dëgjimore dhe në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se pas zhvillimit të hetimeve ndaj Kryetarit Ramiz Azizi, mbetet pranë raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura, se Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan Ramiz Azizi, dyshohet se ka bërë sjellje të pahijshme gjatë dhënies së deklaratës në cilësinë e dëshmitarit në çështjen kontestimore C.nr.79/17, duke deklaruar se “veç sa do të dalësh jashtë apo sa të dalësh jashtë do ta shohësh se kush jam unë”.

Kryetari Ramiz Azizi, në seancën dëgjimore dhe në deklaratimet e bëra para panelit hetimor ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor lidhur me pretendimin se i njëjti të ketë kryer sjellje të pahijshme gjatë dëgjimit të tij në cilësinë e dëshmitarit, duke shtuar se edhe kërkesa e parashtruar në qershor të vitit 2019, tregon për “seriozitetin e kësaj fletëparaqitje”.

Për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, KGJK administroj provat materiale siç janë: raporti i Panelit Hetimor, Raporti mbi provat dhe faktet e mbledhura gjatë procedurës hetimore i datës 09 Tetor 2019, kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor i datës 07.06.2019 i dërguar nga Gjykata Supreme, njoftimi për pranimin e ankesës nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ankesa e parashtruar nga Sevdail Azemi, kërkesa për deklarim në ankesë, ankesa e dërguar nga ZPD, aktgjykimi Nr.79/17 i Gjykatës Themelore Gjilan i datës 03.11.2018, procesverbali i C.nr.79/17 i datës 14 shkurt 2018, procesverbali i mbledhjes së parë të Panelit Hetimor 20.08.2019, procesverbali i Panelit Hetimor i mbajtur më 29.08.2019, procesverbali nga mbledhja e Panelit Hetimor i datës 16.09.2019.

Pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK-ja vlerësoj se nuk ka prova të cilat e vërtetojnë faktin se Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan Ramiz Azizi të ketë kryer sjellje të pahijshme gjatë deklarimit të tij në cilësi të dëshmitarit në çështjen kontestimore C.nr.79/17.

Nga provat e prezantuara nga Kryesuesi i Panelit Hetimor, përkatësisht nga procesverbali C.nr.79/17, shihet se në të nuk është konstatuar asnjë sjellje e pahijshme e kryer nga ana e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi, gjatë dhënies së deklaratës së tij në cilësi të dëshmitarit. Po ashtu, nga ky procesverbal shihet se i njëjti ishte nënshkruar pa vërejtje nga të gjitha palët në procedurë përfshire këtu edhe vet të paditurin tani ankuesin Sevdail Azemi, përkundër mundësisë ligjore që të njëjtit kishin për të bërë një gjë të tillë.


Kurse konstatimin e bërë nga ana e të autorizuarit të të paditurit tjetër Rangjell Bushatoviq avokatit Ahmet Gjinovci se “dëshmitari gjatë dhënies së dëshmisë ka qenë i nervozuar”, Këshilli Gjyqësor e shqyrtoj por të njëjtin e vlerësoi si të paargumentuar dhe si të tillë të pa ndikim për të vendosur ndryshe.

Me nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 lidhur me paragrafin 2, nën paragrafin 2.11 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokurorë është përcaktuar sakte se kur një sjellje e gjyqtarit apo prokurorit konsiderohet si sjellje e pahijshme, e që në rastin konkret nuk u arritë të provohet të jenë bërë nga ana e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan Ramiz Azizit.

Andaj, nga sa u tha më lartë, e në mungesë të provave u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.235/2019, datë: 6 nëntor 2019

Skender COCAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Ramiz, Azizi, Kryetar i Gjykatës Themelore Gjilan;
- Shkelzen Malizi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;
- Arkivit.